

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-154/14

**Prishtinë,
6 Prill 2016**

Në çështjen juridike të:

S. T.

Pala ankuese/Paraqitësi i kërkesës

kundër

Nuk ka

Pala përgjegjëse në ankesë/pala përgjegjëse në kërkesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarë: Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Rolandus Bruin dhe Beshir Islami, anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/C/224/2013 (dosja e rastit është regjistruar në AKP me numrin KPA08841) i datës 27 nëntor 2013, pas seancës së mbajtur me 6 Prill 2016 morri këtë:

AKTGJYKIM

1. **Refuzohet si e pabazuar ankesa e S. T. e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/C/224/2013 të datës 27 nëntor 2013 sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA08841.**
2. **Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/C/224/2013 i datës 27 nëntor 2013 sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA08841.**

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 01 shkurt 2007, S. T. (në tekstin e mëtutjeshëm: Pala Ankuese) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) duke kërkuar ri posedimin e pronës-objekt afarist. Ai pretendon se është pronar i zyrës së avokatisë me sipërfaqe prej 20 m², që ndodhet në Pejë, në ngastrën nr. 240/2, Zona Kadastrale e Pejës me sipërfaqe prej 20m², rruga Jagos Rakocević bb. (në tekstin e mëtutjeshëm: prona e kërkuar)
2. Në kërkesë thekson se të drejtën pronësore në objektin afarist nuk mund ta ushtrojë për shkak të rrethanave që kanë të bëjnë me konfliktin e armatosur që ka ndodhur në Kosovë në vitet 1998/99 ku përmend datën 14 qershor 1999 si datë të humbjes dhe se i njëjti objekt është i zënë nga S.M.
3. Si bazë juridike me të cilën kishte fituar të drejtën në pronën që është objekt i kërkesës ai përmend Aktvendimin Nr. 05-353/40 të lëshuar nga Sekretariati për Urbanizëm, Shërbime Komunale, Banim dhe Ndërtim në Komunën e Pejës me datën 12 prill 1989, por, thekson se të njëjtin nuk e posedon pasi që ishte djegur gjatë konfliktit të armatosur, megjithatë, shton se Sekretaria Ekzekutive e AKP së mund ta gjej aktvendimin në kërkesën e parashtruar nga Mirko Dabetić (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA08840) pasi që të dy kishin fituar nga një lokale afarist në bazë të dokumentit të njëjtë gjithashtu lokalet kufizohen me njëra tjetrën.
4. Identifikimi i pronës ishte bërë, fillimisht më 11 shkurt 2008 me ç rast ishte konstatuar se prona ishte në shfrytëzim nga S.M. M nuk pretendoi të drejtë ligjore ndaj pronës dhe nuk mori pjesë në procedurën para AKP së. Identifikimi i pronës ishte kontrolluar në

janar të vitit 2011 bazuar në koordinatat e GPS-it dhe ortofoton dhe ishte konstatuar se ishte i saktë.

5. Pasi që asnjë palë nuk kishte paraqitur përgjigje në kërkesë brenda afatit ligjor prej 30 ditëve, në pajtim me nenin 10.2 të Ligjit nr. 03/L-079, kërkesa u konsiderua si e pa-kontestuar.
6. Pavarësisht se paraqitësi i kërkesës nuk kishte paraqitur asnjë dëshmi për të mbështetur pretendimin e tij, Sekretaria Ekzekutive e AKP së, zyrtarisht ishte përpjekur të siguroj fletën poseduese për ngastrën në të cilën paraqitësi i kërkesës pretendon të jetë e vendosur prona por përpjekjet kishin dështuar. Për me tepër, Sekretaria Ekzekutive i kishte dërguar paraqitësit të kërkesës një letër për kërkimin e informatave shtesë e cila ishte pranuar nga ai më 1 gusht 2013 por, paraqitësi i kërkesës nuk kishte dorëzuar ndonjë provë tjetër që dëshmon të drejtën e shfrytëzimit apo atë pronësore mbi objektin afarist.
7. Me 27 nëntor 2013, Komisioni me vendimin e tij KKPK/D/C/224/2013 e refuzoi kërkesën për shkak të mungesës së dëshmive. KKPK-ja në arsyetimin e vendimit thekson që paraqitësi i kërkesës ka dështuar të paraqesë ndonjë lloj dëshmie që mund të verifikohet nga Sekretaria Ekzekutive se mbajtësi i pretenduari të drejtës pronësore gëzon të drejta pronësore për pronën e kërkuar, e as Sekretaria Ekzekutive nuk ka siguruar zyrtarisht dëshmi të tillë.
8. Më 5 mars 2013, vendimi iu dorëzua palë ankuese dhe i njëjti ushtroi ankesë në Gjykatën Supreme me 1 prill 2014.

Pretendimet e palës ankuese

9. Pala ankuese kundërshton vendimin për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të fakteve si dhe aplikimit të gabueshëm të së drejtës materiale dhe procedurale.
10. Ankuesi shpjegon se në arsyetimin e vendimit të KKPKsë theksohet se ai ka dështuar të paraqesë ndonjë lloj dëshmie që mund të verifikohet nga Sekretaria Ekzekutive, e as Sekretaria Ekzekutive nuk ka siguruar zyrtarisht dëshmi të tillë. T. pohon se gjatë paraqitjes së kërkesës para AKP së ka deklaruar në mënyrë të qartë, vendimin, numrin e referencës, datën dhe institucionin i cili lëshoi aktvendimin në bazë të cilit ai mbështet të drejtën ndaj pronës, prandaj po të ishte kërkuar nga Sekretaria Ekzekutive në Sekretariatën për Urbanizëm, Shërbime Komonale, Banim dhe Ndërtim të Komunës së Pejës vendimi i përmendur do të gjendej. Më tej pala ankuese thekson se me

Aktvendimin e lartcekur iu ishte miratuar kërkesa për vendosjen e objektit-montazhë të karakterit të përkohshëm, gjithashtu kishte të drejtën e shfrytëzimit të pronës ku ishte i vendosur objekti. Sipas tij ,fakti se e drejta e shfrytëzimit të pronës ku ishte vendosur objekti ishte i karakterit të përkohshëm nuk mund të jetë bazë për refuzimin e kërkesës pasi që në kushte normale ai do të gëzonte këtë të drejtë edhe sot po të mos ndodhte konflikti i armatosur. Pala ankuese thekson se këtë e vërteton edhe fakti se vendimet e tilla kishin një dispozitë me të cilën përfituesi detyrohej ta zhvendosë objektin me shpenzimet e veta, pa kompenzim dhe pa i siguruar të drejtën në sipërfaqe tjetër, sipas urdhëresës së organit kompetent me rastin e rregullimit të tokës ndërtimore dhe një vendim të tillë ai nuk e kishte pranuar asnjëherë.

11. Për arsyet e theksuara me lartë ,pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme që ta caktojë seancë ku do të ftohej ai për të dhënë deklaratë në cilësinë e paraqitësit të kërkesës dhe për të shpjeguar se për çfarë të drejte dhe objekti bëhet fjalë.

Arsyetimi ligjor

12. Ankesa është paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh siç parashihet me Ligjin nr. 03/L-079 dhe është e pranueshme.
13. Megjithatë, ankesa është e pabazuar.
14. Sipas nenit 3.1 të Ligjit Nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka ta drejtë nga Komisioni në urdhër për kthim në posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës “dëshmon” të drejtën pronësore, ose të drejtën e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale dhe se ai ose ajo tani nuk është në gjendje t’i ushtrojnë ato të drejta pronësore për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershor 1999.
15. Nga kjo dispozitë ligjore, rezulton se paraqitësi i kërkesës duhet të paraqet prova në mbështetje të kërkesës që të dëshmojë të drejtën pronësore, ose të drejtën e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme private.
16. KKPK ka mbështetur vendimin e vet mbi faktin që paraqitësi i kërkesës ka dështuar të paraqesë ndonjë lloj dëshmie që mund të verifikohet nga Sekretaria Ekzekutive se mbajtësi i pretenduari i të drejtës pronësore gëzon të drejta pronësore për pronën e kërkuar, e as Sekretaria Ekzekutive nuk ka siguruar zyrtarisht dëshmi të tillë.

17. Ankesa e T. përsëritë pretendimet e njëjta që ai i kishte bërë para KKPK-së. Asnjë provë e re nuk është dorëzuar me ankesën.
18. Lidhur me pretendimin e palës ankuese sa i përket Aktvendimit Nr. 05-353/40 të datës 12 prill 1989 të lëshuar nga Sekretariati për Urbanizëm, Shërbime Komunale, Banim dhe Ndërtim në Komunën e Pejës, gjykata do të bëjë një vlerësim të shkurtër.
19. Pala ankuese nuk mbështeti dokumentin e lartpërmendur. AKP-ja nuk ishte e obliguar ta gjej dokumentin e tillë zyrtarisht. Prandaj , gjykata nuk është e obliguar ta konsideroj pretendimin e tillë. Gjykata Supreme konsideron se edhe po qe se Sekretaria Ekzekutive e AKPsë do të kishte siguruar dhe vlerësuar Aktvendimin e përmendur nga pala ankuese prapë do të rezultonte se pretendimet e palës ankuese se objekti i përkohshëm montazh është send i paluajtshëm do të ishin të pabazuara, të papranueshme dhe të kundërligjshme.
20. Gjykata Supreme konstaton se KKPK ka marrë një vendim të drejtë dhe të bazuar gjatë një procedure të plotë dhe të saktë. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme konstaton se nuk është bërë asnjë shkelje e së drejtës materiale dhe as nuk ka pasur vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike. Gjykata Supreme konstaton se ankesa është e pabazuar.
21. Në bazë të asaj që u tha më lartë dhe në përputhje me nenin 13.3 nën (c) të Ligjit 03/L-079, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore:

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Rolandus Bruin , Gjyqtar i EULEX-it

Beshir Islami, Gjyqtar

Sandra Gudaityte , Referent i EULEX-it

